

UDHËZIM PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË DËNIMEVE  
ADMINISTRATIVE NË PROCESIN E INSPEKTIMIT NGA  
INSPEKTORËT E ZMR-së



---

Miratohet  
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet  
Ministër i Shëndetësisë  
Ilir BEQAJ

---

Sekretari  
Rustem PACI

Nr. 1885 / Prot  
1

Datë 27-12-2016.

## **UDHËZIM PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË PROCESIN E INSPEKTIMIT NGA INSPEKTORËT E ZMR-së.**

### **I. Qëllimi**

Ky udhëzim përcakton rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në zbatim të Ligjit Nr. 8025, datë 09. 11. 1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar, Ligjit Nr.10433, datë 16. 06. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe rregulloreve përkatëse në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

### **II. Rregulla të përgjithshme**

1. Shkelja e kërkesave ligjore që konstatohen nga inspektorët, kur nuk përbën kundërvajtje penale, përbën kundërvajtje administrative, për të cilat vendoset dënimi administrativ përkatës.
2. “Dënim administrativ” është masa e paralajmërimit, gjoja dhe çdo masë apo sanksion tjetër administrativ, të parashikuara në ligjet e mësipërme, apo aktet e tjera nënligjore.
3. Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës, dhe që cënon më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të subjektit të inspektuar.

### **III. Llojet e dënimeve administrative**

1. Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative për të cilat parashikohen dënimet administrative:

- a. Dënim administrativ kryesor;
- b. Dënim administrativ plotësues.

#### ***Dënimi administrativ kryesor përfshin:***

- Paralajmërimin e subjektit, i cili mund të shoqërohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ më të rëndë;
- Dënim me gjobë;
- Heqja e licencës për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues;
- Bllokim i përgjithshëm i aktivitetit.

#### ***Dënimi administrativ plotësues përfshin:***

Çdo masë apo sanksion tjetër administrativ të natyrave të tjera, që shoqëron dënimin kryesor:

- Pezullim të licencës;
- Pezullim i pjesshëm i aktivitetit;
- Rehabilitimin dhe ndreqje e shkeljes së kërkesës ligjore.

Dënimi administrativ kryesor mund të jepet veç, por edhe bashkë me dënime administrative plotësuese. Për të njëjtën shkelje mund të vendoset një dënim kryesor dhe një apo më shumë dënime plotësuese.

Dënimi administrativ, kur është e nevojshme, shoqërohet edhe me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm kohor për këtë qëllim. Në përcaktimin e afatit, inspektori merr në konsideratë rëndësinë e shkeljes, pasojat e saj dhe rrethanat konkrete që përcaktojnë kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për këtë qëllim, me përpjekjet maksimale nga ana e subjektit të inspektimit.

Për shkeljen e kërkesave ligjore, për çdo rast, do të zgjidhet dënimi administrativ i përshtatshëm, sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet të jetë i mjaftueshëm për të arritur zgjidhjen e shpejtë të shkeljes, për të penguar përsëritjen e saj në të ardhmen, si dhe mungesën e bashkëpunimit nga ana e subjektit të inspektuar.

#### **IV. Kriteret për caktimin sipas llojit të masës së dënimit administrativ**

##### **Dënimi administrativ kryesor “Paralajmërim”**

1. Dënimi administrativ kryesor “Paralajmërim” merret kur inspektori konstaton shkelje të kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji nuk parashikon dënimin përkatës administrativ. “Paralajmërimi” jepet në rastet kur subjekti, nuk plotëson nga 1-10 pikë.
2. Subjekti i inspektimit i dënuar me dënimin administrativ “Paralajmërim” mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:
  - a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre;
  - b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore.

##### **Dënimi administrativ kryesor “Gjobë”**

Dënimi administrativ “Gjobë”, është dënim administrativ kryesor, i cili i jepet subjektit të inspektuar kur nuk plotëson treguesit që paraqiten në listat e kontrollit. Masa e gjobës është e shprehur me intervale sipas pikëve të grumbulluara.

##### **Dënimi administrativ kryesor “Heqja e licencës për ushtrimin e veprimtarisë”**

Dënimi administrativ kryesor “Heqja e licencës për ushtrimin e veprimtarisë” merret kur subjekti i licencuar nuk ka bërë amendimin e licencës për ndryshime thelbësore që ka bërë në mjediset ku ushtron aktivitetin, në personel apo ndryshime në inventarin e pajisjeve me burime të rrezatimit jonizues dhe që krijon rrezik për shëndetin e punonjësve popullatës ose dëmtimin e mjedisit, sipas pikës 4 të VKM-së Nr. 10, datë 7.01.2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”. Heqja e licencës mund të shoqërohet edhe me dënime të tjera plotësuese.

**Dënimi administrativ kryesor**  
**“Blokim i përgjithshëm i aktivitetit”**

Dënimi administrativ kryesor “Blokim i përgjithshëm i aktivitetit”, hyn tek masat urgjente dhe merret kur subjektit të inspektuar i konstatohen nivele të larta të rrezatimit të normave të lejuara, ndotje të mjedisit që kërcënojnë shëndetin e popullatës, apo situatash emergjente, etj; sipas nenit 43 pika 1/a dhe b, të Ligjit Nr. 10433, datë 16. 06. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas pikës 7,a, b, c, të rregullores Nr. 10, datë 7.01.2010, “ Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”. Subjekti të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme. Bllokimi i përgjithshëm i aktivitetit shoqërohet edhe me dënime të tjera plotësuese.

**Dënimi administrativ plotësues “Pezullim i licencës”**

Dënimi administrativ plotësues “Pezullim i licencës” merret, krahas dënimit kryesor, në rastet kur subjektit i konstatohen të meta e mangësi serioze në ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 9, të rregullores Nr. 10, datë 7.01.2010, “ Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” .

**Dënimi administrativ plotësues “Pezullim i pjesshëm i aktivitetit”**

Dënimi administrativ plotësues “Pezullim i pjesshëm i aktivitetit”, hyn në masat urgjente dhe merret krahas dënimit kryesor, në rastet kur subjektit i konstatohen defekte në mjetet apo pajisjet me burime të rrezatimit jonizues, të cilat janë të riparueshme, sipas nenit 43, pika 2/a,b,c, të Ligjit Nr. 10433, datë 16. 06. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas pikës 7, (b) të rregullores Nr. 10, datë 7.01.2010, “ Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” .

**Dënimi administrativ plotësues**  
**“ Rehabilitim dhe ndreqje e shkeljes së kërkesës ligjore”**

Dënimi administrativ plotësues “Rehabilitim dhe ndreqje e shkeljes së kërkesës ligjore”, merret në rastet kur subjektit i konstatohen pajisje dhe aparatura tepër të vjetëruara jashtë standardeve, të cilat duhen ndërruar, apo kur mjediset e ushtrimit të aktivitetit duhen riparuar apo të ristrukturohen, etj.

**V. Rastet e dënimit administrativ**

**A. Subjektet e licencuara**

1. Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, pika 6, të Ligjit Nr. 10433, datë 16. 06. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë në vlerë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Pengimi i inspektorit për kryerjen e inspektimit, prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër të vendosura nga inspektorët, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga

10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 54, të Ligjit Nr. 10433, datë 16. 06. 2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

## **VI. Metodologjia e përcaktimit të dënimeve administrative**

1. Subjektet që kanë kryer shkelje të kërkesave ligjore të identifikuar sipas listës së mëposhtme të treguesve, do të penalizohen në bazë të pikëve të grumbulluara për mosplotësimin e treguesve.
  2. Sipas kësaj metodologjie çdo subjekt, përpara çdo inspektimi duhet të ketë 100 pikë për një veprimtari, në përputhje me listat e kontrollit.
  3. Në fund të inspektimit mblidhen të gjitha pikët e plotësimit të treguesve. Në varësi të sasisë së pikëve të grumbulluara nga subjekti bëhet edhe penalizimi i subjektit me dënimin administrativ përkatës.
  4. Në qoftë se në fund të inspektimit subjekti rezulton me pikë të paplotësuara:  
Nga 1-10 pikë, penalizohet me dënimin administrativ “paralajmërim”  
Nga 11-12 pikë, penalizohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë  
Nga 13-15 pikë, penalizohet me gjobë 20 000 (njëzet mijë) lekë  
Nga 16-17 pikë, penalizohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë  
Nga 18-20 pikë, penalizohet me gjobë 40 000 (dyzet mijë) lekë  
Nga 21-23 pikë, penalizohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë  
Nga 24-25 pikë, penalizohet me gjobë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë  
Nga 26-28 pikë, penalizohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë  
Nga 29-30 pikë, penalizohen me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë  
Nga 31-33 pikë, penalizohen me gjobë 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë  
Nga 34-35 pikë, penalizohen me gjobë 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekë  
Nga 36-38 pikë, penalizohen me gjobë 160 000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë  
Nga 39-40 pikë, penalizohen me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë  
Nga 41-42 pikë, penalizohen me gjobë 240 000 (dyqind e dyzet mijë) lekë  
Nga 43-45 pikë, penalizohen me gjobë 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë  
Nga 46 pikë e lart, penalizohen me gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë, si dhe përveç gjobës dënohet edhe me dënime të tjera plotësuese.
- Listat e kontrollit miratohen me urdhër të Kryetarit të ZMR-së, mbështetur në kërkesat e këtij udhëzuesi.

## **VII. Ankimimi i vendimeve për dënimet administrative**

1. Kundër vendimit të dënimit administrativ, kundërvajtësi mund të bëjë ankim tek Kryetari i KMR-së, brenda 15 ditëve, nga data e njoftimit të këtij vendimi dhe në gjykatë, 30 ditë pas vendimit përfundimtar të Kryetarit të KMR-së, sipas pikës 10, të rregullores Nr. 10, datë 7.01.2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues”, si dhe në respektim të afateve të përcaktuara në nenin 132, të Ligjit Nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”
2. Në zbatim të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 21, 22, vendimi për dënimin administrativ përbën titull ekzekutiv.
3. Gjohat duhet të paguhet brenda 10 ditëve nga marrja në dijeni nga kundërvajtësit, pas kalimit

- të këtij afati gjoba ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.
4. Pagesa e gjobave bëhet në numrat e llogarisë ku kryhen veprimet e ZMR-së .